



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 19.01.2021

**RAPORT**

**PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E  
VITIT 2020**

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Këshilli i Bashkisë Durrës, gjatë 12-mujorit të vitit 2020 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit. Prioritare kanë qenë vendimet që i kushtoheshin procesit të rindërtimit pas tërmetit të datës 26.11.2019, si dhe pandemisë botërore Covid-19. Gjithashtu, Këshilli ka marrë dhe vendime, që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale, eliminimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihme financiare, për familje, jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë :

<b>Nr.</b>	<b>Muaji</b>	<b>Ndihmë ekonomike për familje nga të ardhurat e Bashkisë</b>	<b>Ndihmë ekonomike për familje nga Fondi i kushtëzuar 6 %</b>
------------	--------------	--	--

1.	Janar	86	-
2.	Shkurt	86	6
3.	Mars	83	6
4.	Prill	86	11
5.	Maj	89	12
6.	Qershor	88	12
7.	Korrik	90	11
8.	Gusht	88	12
9.	Shtator	92	13
10.	Tetor	92	13
11.	Nëntor	92	13
12.	Dhjetor	90	15

Kemi akorduar bonus strehimi për familjet që përmbushnin kriteret ligjore për të përfituar këtë bonus të akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise në favor të Bashkisë Durrës, gjithsej 62 familje (ku përmendim invalidë, persona PAK, familje të komunitetit egjiptian, persona që gëzonin statusin e jetimit, apo kryefamiljare të divorcurara).

Në zbatim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 Këshilli i Bashkisë Durrës, ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2020 si,

- 5 vendime, për subvencionimin e qerasë për familje që mbetën të pastrehë, për **6038** familje, (për sqarim: duke futur dhe listat e para e të dyta të miratuar në dhjetor 2019 (1310 + 2553) dhe 587 familje që mbetën të pastrehë pas vendimeve të Këshillit për vijimin e procedurave të prishjes së pallateve të tyre apo banesave private, sipas aktekspertizave të thelluara të Institutit Ndërtimit Tiranë.
- 8 vendime për përfituesit nga granti i rindërtimit për banesat e klasifikuara me dëmin ds1, ds2 dhe ds3, (lista e parë deri lista e tetë), nëpërmjet programit “Shtëpia Ime”, për **10.959** familje.
- 13 vendime për përfituesit nga programi i rindërtimit për banesat e klasifikuar me dëmin ds4 dhe ds5, nëpërmjet programit “Shtëpia Ime”, për **1503** familje (riforcim e prishje).

Këshilli ka marrë deri me datë 24.12.2020, pesëmbëdhjetë (15) vendime për miratim të prishjes së detyruar të disa pronave të Bashkisë Durrës, pasi kanë rezultuar të rrezikshme për jetën dhe shëndetin pas tërmetit të nëntorit sipas ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit Tiranë dhe janë rekomanduar të shëmben, si vijon:

- 2 godina - Qendra Shëndetësore në fshatin Likmetaj dhe fshatin Draç
- 3 ndërtesa pjesë të shkollës Njazi Mastori Nj.Ad.Sukth

- 2 godina - konvikti i shkollës Bernardina Qeraxhi dhe 9-vjecare Hasan Koçi
- 4 godina - shkolla Bedrie Bebeziqi, Shaqe Mazreku, Qemal Mici dhe kopshti Met Hasa
- 2 godina - shkolla Xhelal Shtufi (Shkafanë) dhe Rexhep Mezini (Ishëm)
- 1 godinë - shkolla Adem Gjeli (Ishëm)
- 1 godinë - shkolla Vëllezërit Haradinaj (Rrashbull)
- 1 godinë - shkolla Cikli ulët Perlat (Sukth)
- 1 godinë - ndërtesa e Administratës të Njësisë Administrative Manëz
- 1 godinë - godina e shkollës së mesme të bashkuar “Ismet Nanushi”
- 2 godina - godina e Kopshtit Kuçok dhe Kopshti në fshatin Radë
- 1 godinë - ndërtesa e Administratës të Njësisë Administrative Katund i Ri
- 1 godinë - ndërtesa e Administratës të Njësisë Administrative Ishëm
- 1 godinë - shkolla 9 vjeçare Riza Shera (Radë, Nj.Ad.Manëz)
- 1 godinë - ndërtesa me emërtimin “Ambulancë-Kullë- Sukth i ri” (Nj.Ad.Sukth)

Këshilli ka marrë 11 vendime për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të pronave private, sipas akt ekspertizave të thelluara të Institutit Ndërtimit Tiranë si vijon :

- Në prill – 12 objekte pronë private (VKB nr.18)
- Në maj – 2 pallate në Durrës dhe 86 ndërtesa individuale në Manëz (VKB nr.37)
- Në qershor - 12 pallate të ndodhura në Sukth, Manëz, Ishëm, Rashbull, Nj.Ad. nr.4 (VKB nr.52)
- Në qershor - 7 pallate në Sukth, Manëz (VKB nr.54)
- Në korrik - 7 pallate në Njësinë Administrative nr.4 dhe Nr.5 (VKB nr.65)
- Në korrik - 6 pallate në Njësinë Administrative nr.1 , Sukth, Katund i Ri dhe 1 banesë individuale në Njësinë Administrative Nr.5 (VKB nr.66, i ndryshuar VKB nr.108)
- Në korrik - 11 pallate dhe 1 shtesë anësore në qytetin Durrës (VKB nr.68, i ndryshuar me VKB nr.82, dhe VKB nr.108)
- Në gusht - 3 pallate në Njësinë Administrative nr.2 dhe Nr.3, Nr.4 (VKB nr.85)
- Në shtator - 4 banesa private në Njësinë Administrative Nr.5 (VKB nr.91)
- Në tetor - 1 pallat në Njësinë Administrative nr.4 (VKB nr.107)
- Në dhjetor - 1 pallat në Njësinë Administrative nr.4 (VKB nr.121)

Këshilli ka marrë dhe vendime për vijimin e procedurave të miratimit për zonat e lira ku do të ndërtohen banesat për familjet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 , veçanërisht

- Zona 1 –ish UMB shkozet,
- Zona 3 – Njësia Administrative nr.5, Shkozet
- Zona 4 – Njësia Administrative nr.6, Durrës,
- Planin e detyruar vendor pikësor për 4 banesat kolektive të Bashkisë Durrës.

Përsa i përket COVID -19 këshilli ka marrë vendime :

- për një fond prej 8.607.162 lekë për dhënien e produkteve ushqimore nga Bashkia Durrës familjeve,
- gjithashtu ka miratuar listën emërore me 610 familje që përfitonin ndihmë financiare, nga fondet e UNICEF, duke patur në vëmendje familjet në nevojë, invalid, jetim apo dhe pensionistë të vetmuar.
- po kaq të rëndësishme kanë qënë dhe vendimi për shtyrjen e afatit të pagesave të qirave për banesat sociale dhe vendimi për shtyrjen e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore për biznesin e mbyllur me Urdher nr.193 datë 20.03.2020.
- me nismën e Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale kemi miratuar Rezolutën “Mbi marrjen e masave të veçanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga covid-19, për parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.

Ka marrë një vendim për emergjencën civile (*Vendimi nr.50, datë 11.06.2020 “Për miratimin e propozimit të shpalljes së emergjencës mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës për shkak të mbylljes së venddepozitimit të porto-romanos”*)

Krahas këtyre vendimeve kemi miratuar vendime për :

- dhënie me qira të ambjenteve të ndryshme, asete të Bashkisë me qëllim mirëmenaxhimin e tyre
- përdorimin e fondit prej 995.000 lekë për shërbimin në familje për fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës 2-6 vjeç
- shtesë dhe ndryshime të buxhetit për vitin 2020 me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare.
- linjat qytetase të transportit publik, inteneraret, stacionet, oraret dhe frekuencat e tyre,
- disa lehtësira që përfitojnë studentët e paisur me kartën studenti si dhe familjet të cilat përfitojnë reduktim të detyrimit mujor për fëmijet në kopshte e çerdhe,
- dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për z. Vangjel Toçi,
- tarifatat e pajtimit mujor për transportin qytetas në Bashkinë Durrës.
- buxhetin e vitit 2021 dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023
- për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021
- bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2020-2021
- gjithashtu Këshilli ka marrë dhe disa vendime që i përkasin mbarëvajtjes së punës së tij.

**Për periudhën janar – dhjetor 2020, janë marrë 133 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Durrës.**

*(Bashkëngjitur materialit gjeni dosjen e vendimeve ku është përcaktuar saktë numri i vendimit, data e vendimit, data e shpalljes së vendimit, titulli i vendimit, data e miratimit nga Prefekti dhe nr.i fletëve të vendimit dhe dokumentave shoqëruese të tij.)*

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave. Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2020 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për të gjitha vendimet e marra.

Nga Prefektura Durrës është kryer kontroll sipas legjislacionit dhe në raportin përfundimtar të datës 06.11.2020 është cilësuar se Këshilli Bashkiak Durrës ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore si dhe rekomandimet e lëna nga kontrollet e mëparshme.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Durrësit.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhje te radhës, mbledhje jashtë radhe dhe mbledhje të jashtëzakondshme, sipas tabelës së mëposhtme :

<b>Muaji</b>	<b>Nr i mbledhjeve</b>	<b>Mbledhje të radhës</b>	<b>Mbledhje jashtë rradhe</b>	<b>Mbledhje të jashtëzakondshme</b>
Janar	1	1 (29.01.2020)	-	-
Shkurt	1	1 (27.02.2020)	-	-
Mars	1	1 (30.03.2020)	-	-
Prill	3	1 (29.04.2020)	-	2 (09.04.2020,23.04.2020)
Maj	4	1 (29.05.2020)	1 (20.05.2020)	2 (12.05.2020,14.05.2020)
Qershor	4	1 (30.06.2020)	1 (25.06.2020)	2 (11.06.2020,26.06.2020)
<b>Total 6 mujor parë</b>	<b>14 +1 qarkullues</b>	6	2	6
Korrik	6	1 (30.07.2020)	-	5 (07.07.2020,14.07.2020, 15.07.2020, 20.07.2020, 24.07.2020)
Gusht	2	-	2 (10.08.2020,31.08.2020)	-
Shtator	1	1 (30.09.2020)	-	-

Tetor	2	1 (30.10.2020)	1 (12.10.2020)	-
Nëntor	1	-	1 (27.11.2020)	-
Dhjetor	1	1 (24.12.2020)	-	-
<b>Total 6 mujor dytë</b>	<b>13</b>	4	4	5

Periudha	Nr i mbledhjeve	Mbledhje të radhës	Mbledhje jashtë rradhe	Mbledhje të jashtëzakondshme
6 mujori parë	14 +1 qarkullues	6	2	6
6 mujori dytë	13	4	4	5
<b>Total 12 mujori</b>	<b>27 +1 qarkullues</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>11</b>

Me datë 12.03.2020, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, janë marrë vendime qarkulluese, pasi ishte e pamundur mbledhja në sallë e Këshilltarëve dhe akti normativ që lejonte mbledhjet online hyri në fuqi me datë 15.03.2020

Gjatë muajit Mars-Dhjetor 2020 mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar online për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, përveç 2 mbledhjeve me datë 30.06.2020 dhe 30.07.2020, ku Këshilli ka mbajtur senacën plenare në sallën e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” (duke zbatuar protokollin e sigurisë së institucionit, për masat e marra kundër Covid – 19, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale)

Vlen për tu përmendur se pjesmarrja e këshilltarëve ka qënë më aktive si në mbledhjet e komisioneve ashtu dhe në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet plenare online.

Komisionet e përhershme të këshillit janë mbledhur për të diskutuar dhe miratuar projekt vendimet e sjella nga administrata e Bashkisë Durrës. Për periudhën 12-mujore janë bërë 130 mbledhje të komisioneve, pjesa më e madhe është mbajtur online në kushtet e pandemisë.

Nr.	Muaji	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Janar	2
2.	Shkurt	5

3.	Mars	3
4.	Prill	16
5.	Maj	19
6.	Qershor	16
	<b>Total 6 mujori I-rë</b>	<b>61</b>
7.	Korrik	20
8.	Gusht	15
9.	Shtator	11
10.	Tetor	12
11.	Nëntor	1
12.	Dhjetor	10
	<b>Total 6 mujori II-të</b>	<b>69</b>
	<b>TOTALI 12 MUJOR</b>	<b>130</b>

Në çdo rast komisionet e përhershme në zbatim të rregullores kanë mbajtur raportin perfundimtar ku pasqyrohet vendimarrja e secilit komision, sipas tabelës së mëposhtëme :

Nr.	Komisioni	6 mujori parë 2020					
		<b>RAPORTE E PROCESVERBALE TE KOMISIONEVE</b> <i>sipas pikave të rendit të ditës</i>					
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	1	1	-	2	4	5
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	-	-	-	3	6	2
3.	Komisioni Mandateve	-	-	-	1	-	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	-	1	-	7	5	8
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	-	-	1	3	3	5
6.	Komisionit Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	-	-	-	-	-	-

7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	1	1	-	-	-	-
8.	Komisioni të Mardhënieve me Jashtë	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	-	-	-	1
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale	1	1	1	1	2	1
11.	Komision i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	-	1	1	5	5	2
12.	Komisionit të Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	-
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	-	-	-	-
14.	Komisionit Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
	<b>Totali – 82</b>	3	5	3	22	25	24
<b>Nr.</b>	<b>Komisioni</b>	<b>6 mujori dytë 2020</b> <b>RAPORTE E PROÇESVERBALE TE KOMISIONEVE</b> <b>sipas pikave të rendit të ditës</b>					
		<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>
1.	Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike	10	9	4	8	-	4
2.	Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	4	8	2	6	-	3
3.	Komisioni Mandateve	-	-	-	-	-	-
4.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	10	6	2	7	-	4
5.	Komisioni Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave	2	2	3	4	-	4
6.	Komisionit Mbrojtjes	-	-	-	1	-	-



	Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë						
7.	Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	-	-	-	1	-	3
8.	Komisioni të Mardhënieve me Jashtë	-	-	-	-	-	-
9.	Komisioni Mjedisit dhe Trajtimit të Mbetjeve	-	-	-	-	-	-
10.	Komisioni Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale	1	1	1	1	1	1
11.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	3	1	4	1	-	3
12.	Komisionit të Politikave të Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-	-
13.	Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit	-	-	-	-	-	-
14.	Komisionit Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve	-	-	-	-	-	-
15.	<b>Totali 6 mujori II-të 125 raporte</b>	<b>30</b>	<b>27</b>	<b>16</b>	<b>29</b>	<b>1</b>	<b>22</b>

Nr.	Periudha	Raportet e Komisioneve të Përhershëm
1.	Totali 6 mujori I-rë	82
2.	Totali 6 mujori II-të	125
	<b>Totali 12 mujor</b> <i>p.s (1 pikë e rendit të ditës është shqyrtuar nga më shumë se 1 komision)</i>	<b>207</b>

**Nga karakteri i vendimeve mund t'i ndajmë në:**

- 1. për probleme financiare – 17 vendime,**
- 2. për probleme sociale – 14 vendime,**

- 3. për infrastrukturën dhe strehimin - 60 vendime,**
- 4. për problemet urbane dhe asetet - 20 vendime,**
- 5. për emergjencat civile – 2 vendime,**
- 6. për probleme të arsimit kulturës -6 vendime,**
- 7. të ndryshme - 14 vendime**

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, konkretisht me prishjet e godinave, shkollave, kopështet, qëndrave shëndetsore pallateve e shtëpiave individuale në qytet dhe të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Durrës, të dëmtuara nga tërmeti me qëllim ndërtimet e tyre të reja nga fondi i rindërtimit akorduar nga Qeveria.

#### **Vlen të përmendet fakti se gjatë këtij viti Këshilli Bashkiak miratoi :**

1. Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës me unanimitet të votave, me Vendim nr.25, datë 29.04.2020
2. Kodi i sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të Këshilltarit Bashkiak”, me Vendim nr.25, datë 29.04.2020
3. Rregulloren për marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median, me Vendim nr.90, datë 30.09.2020
4. Rregulloren për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare, me Vendim nr. 103, datë 30.10.2020

Këto rregullore u propozuan nga AMVV Tiranë dhe projekti “Bashki të forta”, duke u përshtatur nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike pranë Këshillit me punën dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë Durrës.

*Është pasuruar faqa online e Këshillit Bashkiak me informacione për publikun nëpërmjet kartelave të mëposhtëme :*

Rreth Këshillit Bashkiak

Struktura e Këshillit Bashkiak

Anëtarët e Këshillit Bashkiak

Përbërja e Komisioneve

Konferenca e Kryetarëve

Legjislacioni

Rregulloret

Vendime të Këshillit Bashkiak

Regjistri i Konsultimeve Publike

Raporte të Këshillit

Model formatesh për t'u shkarkuar nga komuniteti

Regjistri elektronik i kërkesave, ankesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare

Dëgjesa Publike

Sekretariati i Këshillit ka zbatuar me korrektësi kërkesat e ligjit për njoftimet publike ( *si në faqen zyrtare të Bashkisë, në media vendore, me email drejtuar OJF, Drejtorëve të bashkisë apo dhe Deputetëve, në këndin e informacionit në zyrën e mardhënieve me publikun në Bashkinë Durrës*) në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar dhe Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, por në të ardhmen do të bëhet e mundur jo vetëm njoftimi në faqen e Bashkisë apo në media vendore por dhe njoftimeve e shpalljeve në të gjitha njësitë administrative e lagjet e qytetit, ku për këtë është e nevojshme mbështetja nga nënpunësit e njësive administrative.

Në protokollin e Sekretariatit kanë hyrë 270 shkresa zyrtare dhe kanë dalë 129 shkresa zyrtare. Në postën elektronike kanë hyrë 601 email, dhe kanë dalë 547 email.

Gjithashtu në Sekretariat si me shkresa dhe me email, janë dorëzuar 7 ankesa dhe 31 kërkesa, të cilave sekretariati në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit, i është përgjigjur, brënda afateve ligjore dhe 4 prej tyre janë në proces.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës në fund të çdo mbledhje është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Këshilli Bashkiak ka patur në buxhetin e tij të miratuar për vitin 2020 :

Për zërin 602 – 50.000 lekë (kancelari, distinktivë, stenda informuese për emra, perde zyre, kartolina)

Për zërin 231 – 840.000 lekë ( karrige për sallën e këshillit, kondicioner zyre)

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014 “Për konsultimin Publik” gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, këshilli nuk ka mundur të zhvilloj shumë dëgjesa publike, pasi situata e krijuar mbas tërmetit të datës 26.11.2019 si dhe pandemia Covid-19 e bënë të pamundur një gjë të tillë.

Megjithatë përsa i përket miratimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021, të buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetit afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023, Këshilli ka mbajtur 2 seanca dëgjimore me datë 8.12.2020 me një numër të

kufizuar pjesmarrësish deri në 10 persona dhe një seancë dëgjimore online me datë 15.12.2020 (realizuar me ndihmesën e CSDC Durrës dhe administratën e Bashkisë).

Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjell shqetësimet e sygjerimet e tij.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimarrje të komunitetit.

Administratorët e lagjeve dhe të njëjësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësave publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme do të bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Për sa më sipër vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesa në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit.

Faleminderit !

Falenderimet gjithashtu shkojnë për....

- Falenderojmë për punën e palodhur dhe në orë të vona, në këtë vit të vështirë, administratën e Bashkisë Durrës dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti Drejtorinë Juridike, Kabinetin e Kryetarit, Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë e Shërbimeve, Komisionet apo Zyrën e Rindërtimit, Protokollin dhe Zyrën e Mardhënieve me Publikun.
- Falenderojmë për asistencën teknike në mbledhjet plenare online znj.Eneida Marku koordinatorë e projektit “Bashki të Forta”
- Falenderojmë për ndihmën në dëgjësat publike CSDC Durrës me Drejtore Ekzekutive znj.Miriam Reçi.